

ELONA GJATA

**KONGRESI ARSIMOR I LUSHNJËS PËR TERMINOLOGJINË
GJUHËSORE**

Abstrakt

Një ndër çështjet që kërkonte zgjidhje imediate në periudhën e vitit e 1920 ishte problemi i unifikimit të sistemit arsimor. Kështu, mbledhja e një Kongresi ishte e pashmangshme. Për këtë, Sotir Peçi, ministër i Arsimit, pa si të udhës njoftimin e Këshillit të Ministrave, me në krye Aqif pashë Elbasanin, për formimin e një komisioni teknik. Kongresi u mbajt në qytetin e Lushnjës, duke pasur parasysh edhe rëndësinë e tij historike.

Rëndësia e këtij Kongresi nuk do të ngelet vetëm në rëndësinë historike në rrafshin kombëtar, por akoma edhe më shumë, në kontributin që ky Kongres dha në terminologjinë gjuhësore. Kontributi më i madh në këtë lëmë, padyshim, mbetet ai i A. Xhuvanit. Këtu do të hasim një grup termash që i kemi edhe sot në përdorim, si zanore, rrokje, diftong, përemër, fjalë, emër, fjali etj. Midis këtyre termave, ose siç janë quajtur në këtë Kongres, fjalëskaje, gjejmë terma të fonetikës, morfologjisë dhe sintaksës.

Megjithëse ky Kongres, siç e patën theksuar edhe patriotët pjesëmarrës, nuk qe një Kongres gjuhësor, por thjesht teknik, ai pati meritën e madhe në rrafshin arsimor dhe atë pedagogjik, e sidomos në kontributin e terminologjisë gjuhësore, që do të përdorej më vonë në të gjitha shkollat e vendit, nëpërmjet gramatikave shkollore të hartuara prej A. Xhuvanit.

Problemi i unifikimit të sistemit arsimor mbeti një nga çështjet që kërkonin zgjidhje imediate në periudhën e vitit 1920. Më 26 korrik të po këtij viti, Sotir Peci, ministër i Arsimit, njoftoi Këshillin e Ministrave, me në krye Aqif pashë Elbasanin, për formimin e një komisioni teknik, në të cilin do të merrnin pjesë 12 arsimtarë, më të mirët nga i gjithë vendi. Në një letër, dërguar Aqif pashë Elbasanit, Sotir Peci shprehet se “Ky kongres nuk është djalektim e për gjuhë, por vetëm teknik”¹.

Për mbajtjen e Kongresit ai caktoi Lushnjën, si vend me rëndësi historike. Kongresi u mbajt më 15 gusht 1920. Anëtarët e këtij Kongresi u caktuan: *Aleksandër Xhuvani, Ilia Dilo Sheperi, Zef Fekeçi, Ahmet Gashi, A. Kondili, Dhimitër Mborja Belkameni, G. Mikeli, Th. Papapano, I. Anamali, N. Paluca* e të tjerë². Kryetar i Kongresit u zgjodh Zef Fekeçi³. Në mbledhjen e parë që

¹ AQSH, FNr. 295, DNR. 9, Viti 1920, f. 5.

² Fondi i arkivit Lushnjë.

mbajti Kongresi u fol për rëndësinë që do të kishte ky Kongres. Në fjalimin që zoti Mborja mbajti, ai përmendi se “një popull pa arësim s’mund të rrojë as s’ka drejtë të rrojë”⁴.

Në mbledhjen e dytë të këtij Kongresi, rendi i ditës që caktimi i fjalëskajeve më të nevojshme të gramatikës, që do të përdorehin në të gjitha shkollat kombëtare. Por, ajo që duhet theksuar është se këto fjalëskajeve ishin vetëm terma teknikë⁵.

gramatikë = grammatica
 fjalia – i = proposition
 fjalë- a = verbum
 rrokë-ja = sillaba
 zâ = (vox) suonus
 zanore = vocalis
 bashkxanore = consonans
 germë-a = lettera
 dyzanore = diphtongus
 emën = substantivum
 nyje-nyja- = articulus
 gjini = genus
 mashkullore = masculinum
 femnore = femmininum
 astjatër = neutrum
 numër = numerum
 njëjës-i = singular
 shumës-i = plural
 i caktuem = determinativum
 i pacaktuem = indeterminativum
 lakim = declinatum

Duke qenë se në mbledhjen e 15 gushtit 1920 nuk mundën të vinin misët e Kongresit nga Elbasani, Gjirokastra, Berati etj. u krye një mbledhje e tretë, e cila pa si të arsyeshme që këtyre zotnive t’i dëftehej protokollin i dy mbledhjeve të mëparshme. Në këtë mbledhje, të mbajtur më 16 gusht 1920, Ministria e Arsimit kishte emëruar për kryetar, drejtorin e “Normales”, A. Xhuvanin, por ky i fundit nuk deshë që të prishej vendimi i bërë në mbledhje të parë, kërkoi që si kryetar i Kongresit të mbesë përsëri Z. Fekeçi. Në këtë

³ AQSH, FNr. 295, DNR. 9, Viti 1920, f. 19.

⁴ Protokollin I, Fondi i arkivit Lushnjë.

⁵ Protokollin II, Fondi i arkivit Lushnjë.

Kongresi arsimor i Lushnjës për terminologjinë gjuhësore

mbledhje u kërkua që të shqyrtoheshin edhe njëherë fjalëskajet e gramatikës, që ishin caktuar që në mbledhjen e dytë⁶.

fjali-a = proposition
tingëll-i = suonus
zânore-ja = vocalis
bashktingllore-a = consonans
dytingllore-a = diphtongus
shkroje-a = grafi
rasë-a = causa
emnore = nominativum
gjinore = genitivum
dhanore = dativum
kallzore = acusativum
thirrore = vocativum
vendore = locativum
rrjedhore = ablativum
mbiemër = adjectivum
pohenik = positivus
krahanik = comparativus
sypërnik = superlativus
përemni = pronomen
vetëtuer = personalës pronomen
zotnuer = posesivum pronomen
diftuer = demonstrativum pronomen
pyetuer = interrogativum pronomen
permenduer = relativum pronomen
sasuer = quantitativum pronomen
bredhuer = reflexivum pronomen
i paskajuem = indefinitivum pronomen
njënitjetruer = reciprocum pronomen

Përveç rëndësisë historike, ky Kongres pati edhe meritën e madhe për krijimin e një terminologjie nga fusha e gjuhësisë. Midis këtyre termave kemi terma të fonetikës, morfologjisë, sintaksës etj.⁷

Në këtë Kongres ai dha një ndihmesë të madhe në shqipërimin e shumë termave gjuhësorë, si tingull, zanore, bashkëtingëllore, diftong, rrokje, zë,

⁶ Protokollu II, Fondi i arkivit Lushnjë.

⁷ L. Turhani, *Kongresi arsimor i Lushnjës për terminologjinë shkollore*, “Gjuha shqipe në 100 vjet shtet shqiptar”, Tiranë, 2013.

grafemë, fjali, përemër, mbiemër, rasë, paskajore, etj.⁸ Ndërsa disa prej fjalëskajeve, si pohenik, krahanik, sypërnik, sot i gjejmë të përshtatur me termat: pohore, krahasore, sipërore, të cilët tregojnë shkallët e mbiemrit. Ndërsa përemrat vetëtuer, zotnuer, permenduer, bredhuer, i paskajuem, njënitjetruer i gjejmë të përshtatur me përemër vetëvetor, pronor, lidhor, reflexiv, paskajore, reciprok (njëri-tjetrin). Siç vërejmë nga një pjesë e mirë e termave të mësipërm ai ka ndjekur rrugën e kalkimit⁹ nga latinishtja dhe anglishtja, në vazhden e pararendësve të tjerë, sidomos të K. Kristoforidhit, p.sh. mbiemër (adjectivum), zânore (vocalis), fjali (proposition), fjalë (verbum), njënitjetruer (reciprocum), krahanik (comparativus), pohenik (positivus), sypërnik (superlativus), permenduer (relativum pronomen), etj.

Pjesa më e madhe e termave që gjenden sot në përdorim, të krijuar prej tij apo pararendësve të tjerë, pasi një pjesë e mirë e termave janë të krijuar së pari nga Kristoforidhi e S. Frashëri, ku në të shumtën e rasteve ndryshon vetëm forma. Po t'i referohemi gramatikës së Kristoforidhit "Gramatikë e gjuhës shqipe sipas dialektit toskë" (1882) do të hasim një terminologji të pasur gramatikore¹⁰. Këtu do të përmendim bashkëtingëllore, zanore, diftong, lakim, rasë, nyje (të cilën e quan nyje eptike ose të përparme, për të dalluar gjininë; nyjat sintaktike, të cilat shënojnë pronë ose të përkrituri diçkaje), emër, mbiemër, folje, numëror (të ndarë në absolutë, numërorë shpërndarje, shumëzimi, rreshtorë) lakim, ndajfolje, rreth pohorëve, krahasorëve, të cilët i ndan në absolutë dhe relativë, dhe sipërorëve, të cilët lidhen me shkallët e mbiemrit, përemrat vetorë, pronorë, dëftorë, lidhorë, të caktuar, vetvetorë, të pacaktuar, pësorë reciprokë, pyetës, parafjalë, lidhëza, pasthirrma etj.

Gjithashtu një terminologji të pasur gjejmë edhe të "Shkronjëto e Gjuhës Shqip" të Sami Frashërit (1886). Këtu do të përmendim termat fjalë, rrokje, shkronjë, emër, gjindeja (gjinia, të cilën e ndan në femërore, mashkullore, astjatër – asnjansë), numër, rasa (rënja), shquarsia (çqimi) dhe pashquarsia (paçqimi), nyja, mbiemri, përemri, të cilin e ndan në vetor, pronor (gjëtregonjës), pyetës, i pacaktuar (ndamës), lidhor (përmendës), dëftonjës (dëftor), folje, parafjalë (parjetë), lidhëzat (lidhjetë), pasthirrmat (thirjetë).

Këto terma i hasim më vonë edhe në këtë kongres, të cilat janë përgjithësuar sidomos nëpërmjet gramatikave shkollore të hartuara nga A. Xhuvani.¹¹ Por, ajo që duhet theksuar është se kjo traditë ka vazhduar edhe

⁸ Sh. Demiraj, A. Xhuvani *si vazhdues i veprës së Konstandin Kristoforidhit*, Tiranë, 1986, Studime për nder të A. Xhuvanit, f. 127.

⁹ Vep. e cit. f. 129.

¹⁰ *Gramatika e gjuhës shqipe sipas dialektit toskë*, përkthyer nga greqishtja nga A. Spiro, Silver, 2001.

¹¹ M. Domi, A. Xhuvani *lëvruet dhe studiues i shquar i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986, Studime për nder të A. Xhuvanit, f. 49.

para këtij kongresi. Duke iu referuar gramatikës së Xhuvanit “Libri i gjuhës a gramatikë, pjesa e I, për rendin e tretë të shkollës fillore” (1919), do të hasim një terminologji shumë të pasur gramatikore, duke përmendur një grup termash: zanore, rrokje, bashktingllore, dyzanor, fjalë, e paravume (kryefjala), kallzoja (folja), emni, mbiemni, nyjë të mbrapme e të përparme, gjinija, numri, numërorët, përemni (lidhor, vector, diftor, pronor, i pakufishëm), ndajfolje, paraprijësa (parafjala), lidhore (lidhëza), thirrma (pasthirrma)¹².

Por, duke u ndalur te gramatikat e mëvonshme, te “Libri i gjuhës shqipe, pjesa e dytë, për klasën e IV të shkollës fillore” (1920), ku pjesa e dytë e kësaj gramatike përveç analizës fonetike, morfologjike të gjuhës, përmban edhe njohuri për ligjëratën edhe pjesët e saj, analizë për cilësorin, plotësorin kallëzuesin dhe kryefjalën, analizë gramatikore dhe logjike e fjalisë dhe e periudhës, llojet e fjalisë¹³.

Këtë lloj analize, sidomos morfologjike dhe sintaksore, e gjejmë edhe te “Libri i gjuhës shqipe, për klasën e III të fillores” (1924). Këtu do të gjejmë të analizuar emrin, ku përveç shquarsisë dhe pashquarsisë, i ndan në të përveçëm edhe të përgjithshëm, lakimin, nyjën, gjininë, numrin, mbiemrin, të cilin i ndan edhe shkallët, shkalla e parë (barazisë), e dytë (krahasore) dhe e tretë (e sipërisë), përemri, ndajfolja, parafjala, lidhëza, pasthirrma; nga fonetika kemi termat shkronjë dhe zanore. Ndërsa, analiza sintaksore përfshin analizën e kryefjalës, kallëzuesit dhe fjalisë, të cilën, këtë të fundit, e ndan të thjeshtë dhe e zgjânueme (e zgjeruar apo e përbërë ndryshe).

Kontributi i Xhuvanit, për sa i përket formimit të fjalëve terma, nuk mbetet vetëm në fushën e gjuhësisë, por edhe në psikologji, pedagogji dhe kulturë të përgjithshme. Por, ajo që mbetet për t’u përgëzuar është që A. Xhuvani së bashku me plejadën pararendëse, S. Frashërin, K. Kristoforidhin, etj. hodhën themelet e terminologjisë gjuhësore, të cilën e gëzojmë edhe sot¹⁴.

Megjithëse ky Kongres, siç e patën theksuar edhe patriotët pjesëmarrës, nuk qe një Kongres gjuhësor, por thjesht teknik, ai pati meritën e madhe në rrafshin arsimor dhe atë pedagogjik, e sidomos në kontributin e terminologjisë gjuhësore, që do të përdorej më vonë në të gjitha shkollat e vendit, nëpërmjet gramatikave shkollore të hartuara prej A. Xhuvanit.

BIBLIOGRAFI

Fondi arkivit, Lushnjë.

AQSH, FNR. 295, DNR. 9, viti 1920.

K. Bevapi, *Bibliografia për historinë e arsimit 1844-1939*, SHBLSH.

¹² A. Xhuvani, *Libri i gjuhës a gramatikë, pjesa e I për rendin e tretë të shkollës fillore*, Shtypshkronja Elbasani, 1919, f. 7-53.

¹³ K. Bevapi, *Bibliografia për historinë e arsimit 1844-1939*, SHBLSH, f. 138.

¹⁴ L. Dodbiba, *Kontributi i A. Xhuvanit në terminologjinë shqipe*, Tiranë, 1986, Studime për nder të A. Xhuvanit, f. 112.

- A. Xhuvani, *Libri i gjuhës shqipe, pjesa e dytë, për klasën e IV të shkollës fillore*, 1920.
- A. Xhuvani, *Libri i gjuhës a gramatikë, pjesa e I, për rendin e tretë të shkollës fillore*, Shtypshkronja “Elbasani”.
- A. Xhuvani, *Libri i gjuhës shqipe, për klasën e III të fillores*, Tiranë, 1924, Shtypshkronja “Mbrothësija”.
- Sh, Demiraj, A. *Xhuvani si vazhdues i veprës së Konstandin Kristoforidhit*, Tiranë, 1986, Studime për nder të A. Xhuvanit.
- M. Domi, A. *Xhuvani lëvrues dhe studiues i shquar i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986, Studime për nder të A. Xhuvanit.
- L. Dodbiba, *Kontributi i A. Xhuvanit në terminologjinë shqipe*, Tiranë, 1986, Studime për nder të A. Xhuvanit.
- L. Turhani, *Kongresi arsimor i Lushnjës për terminologjinë shkollore, Gjuha shqipe në 100 vjet shtet shqiptar*, Tiranë, 2013.